

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjiilan- dega në Kamenicë, përmes gjyqtarës së vetme Valbonë Dërvodeli, me sekretaren juridike Emine Zubaku, në çështjen penale kundër të akuzuarit N.R. nga ..., për shkak të veprës penale sulm, nga neni 187 parag. 3 lidhur me para. 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së PTH-së nga Gjilani PP.II.nr.702/2014 të dt.31.03.2014, në shqyrtimin e hapur gjyqësor, më dt.12.05.2016 komunikoi, ndërsa më dt.31.05.2016 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari,

N.R., pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga i ati J. dhe e ëma M., i lindur më „data e lindjes,, në ..., ku edhe jeton, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, në bazë të evidencës që disponon kjo gjykatë i dënuar më parë për vepër tjetër penale, nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

Në pajtim të nenit 364. pika . 1.3 i KPRK-së

LIROHET NGA AKUZA

Sepse më datë 15.03.2014, rreth orës 11.40 , në ..., i pandehuri ka sulmuar të miturin E.H, në atë mënyrë që për derisa i mituri së bashku me kafshët, ishte duke shkuar në drejtim të shtëpisë së tij, i pandehuri kishte dalë në rrugë dhe pas mosmarrëveshjeve duke pretenduar se kishte vjedhur në podrumin e shtëpisë së tij tani të dëmtuarin e kishte goditur me duar në fytyrë.

- me çka kishte për të kryer veprën penale sulm nga neni 187 parag. 3 lidhur me para. 1 të KPRK-së.

I dëmtuari E.H. me përfaqësuesin e tij ligjor, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në ngarkesë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate .

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjiçan, me aktakuzë PP.II.nr.702/2014 prej datës 31.03.2014, ka akuzuar N.R. nga ..., për shkak të veprës penale, sulm nga neni 187 parag. 3 lidhur me par. 1 të KPRK-së, pranë të cilës ka mbetur edhe në fjalën përfundimtare me propozim që i akuzuari të deklarohet fajtor dhe të dënohet në përputhje me ligjin.

I dëmtuari E.H. me përfaqësuesin e tij ligjor H.H. iu ka bashkangjitur ndjekjes penale dhe ka parashtruar kërkesë pasurore juridike.

I akuzuari N.R. në mbrojtjen e tij nuk e konteston faktin, se me familjen e E. ka pasur probleme edhe herave tjera përpos rastit konkret, pasi që bashkëshortja e tij e ka takuar E. duke dalur nga podrumi i shtëpisë së tyre, për këtë e ka parë të arsyeshme që të njoftoj babain e E., i njëjti e ka pritur shumë mirë dhe i ka thënë *“poqëse e takon edhe njëherë lirisht mund ta rrahësh mirëpo i njëjti ia ka kthyer se nuk mund ta rrah fëmijën e huaj”*, ditën konkrete derisa ka qenë në shtëpi në afërsi të shtëpisë ka parë E. duke hyrë në podrum të shtëpisë, i cili podrum nuk ka dyer dhe nga aty ka marr kablo të cilën e ka vendosur nën rroba, nga terasa ia ka tërhequr vërejtjen se po i duket një fije e kablos nën rroba i njëjti duke ikur e ka fyer, mohon në mënyrë kategorike veprën penale e cila vihet në barrë duke mos kontestuar që E. ka mundur të ketë qarë me arsyetimin se është friguar pasi e ka takuar duke marr kablo dhe për tu arsyetuar te prindi ka qarë kinse e kam rrahur pas këtij rasti E. nuk është parë në oborrin e shtëpisë së tij.

Në fjalën e tij përfundimtare, nuk e ndien veten fajtor për kryerjen e kësaj vepre penale, kërkon nga gjykata që ta shqyrtoj sa më drejtë këto rrethana dhe ta liroi nga përgjegjësia penale.

Gjykata ka proceduar provat e propozuara, ka dëgjuar të dëmtuarin në cilësi të dëshmitarit E. H. në prezencën e prindit dhe të përfaqësuesit të QPS-së, dëshmitarët: I. B., Sh. Sh., si dhe është lexuar informata e QKMF-së në Kamenicë e datës 10.05.2016.

Nga provat që janë proceduar në këtë çështje penalo juridike nuk është provuar teza nga akuzat e prokurorit të shtetit se i akuzuari ka kryer veprën penale sulm nga neni 187 par.3 lidhur me para. 1 të KPRK-së, për arsye si në vijim:

Në këtë çështje penalo juridike vetëm një rrethanë nuk ka ngel në mëdyshje se, ditën konkrete i akuzuari ka pasur një mosmarrëveshje me fëmijën E. H. pra gjendja faktike e përshkruar në dispozitivin të aktakuzës nuk u vërtetua nga provat e proceduara në shqyrtim gjyqësor, si nga deklaratat e dëshmitarëve, I. B. e Sh. Sh.

Prokurori i shtetit aktakuzën e ka bazuar vetëm në dëshminë e të dëmtuarit fëmiut E. H. i cili në dëshminë e tij ka deklaruar se derisa ka qenë duke u kthyer me bagëti në shtëpi, i akuzuari ia ka zënë rrugën dhe ky nga friga ka hyrë në një oborr të shtëpisë tjetër më pas i akuzuari e ka dërguar një djalë të vëllait diku rreth 21 vjeq për ta zënë, ky djali ka mbajtur duart ndërsa i akuzuari e ka goditur me shuplaka në fytyrë 5-6 herë, arsyeja pse e ka rrahur sipas të dëmtuarit është se i njëjti ka hedhur mbeturina në afërsi të lumit, ndërsa i akuzuari kinse donë ta ruaj ambientin, me të akuzuarin nuk ka pasur probleme herav tjera, pasi është rrahur nga i akuzuari nga shtëpia personalisht ka ftuar policinë, të cilët në vend të ngjarjes kanë ardhur mbrenda 20 minutave, ditën konkrete së bashku me prindin ka qenë në QKMF në Kamenicë.

Gjykata nga deklarata e dëshmitarit I. B. vërtetoi, se ditën konkrete me datë 15.03.2014, pasi janë njoftuar për një ankesë në ka shkuar menjëherë në fshat, kanë takuar, të miturin E. H. para shtëpisë së vet duke qajtur, gjatë bisedës me te kanë parë se i njëjti ka qenë i skuqur duke qarë ndërsa nuk ka pasur shenja të rrahjes pas pak është ardhur edhe prindi i tij, sipas të miturit, N. R. ia ka mëshuar dy shuplaka, për rastin konkrete nuk ka pasur asnjë dëshmitar okular, i dyshuari nuk ka pranur se e ka goditur të miturin i njëjti ka njoftuar për të miturin se në shtëpinë e tij është takuar 2-3 herë duke vjedhur, kështu që ditën konkrete pasi e ka parë vetëm ia ka tërhequr vërejtjen që mos t'i përsërisë veprimet e tija, të dëmtuarit i kanë propozuar që ta dërgojnë të marr ndihmë mjekësore mirëpo i mituri së bashku me prindin kanë refuzuar që të shkojnë të mjekut, në bazë të shikimit që kanë mundur ta vërejnë te i mituri nuk janë vërejtur gjurmë të goditjes, në konsultim me prokurorin e shtetit është përpiluar kallëzim penal,

Nga deklarata e dëshmitarit Sh. Sh. gjykata vërtetoi, se i njëjti nuk ka qenë i kyqur drejtpërdrejtë në rast, nuk ka njohuri se çka ka ndodhur në teren, vetëm ka nënshkruar rastin duke u bazuar në dokumentacionin e nevojshëm i cili nevojitet për ta iniciuar një rast të zakonshëm në polici.

Përfaqësuesi ligjor-prindi i të dëmtuarit, H. H., ka pretenduar se ditën konkrete pasi i mituri është sulmuar nga i pandehuri N.R. i njëjti ka kërkuar ndihmë mjekësore në QKMF në Kamenicë e ky raport asnjëherë nuk iu është bashkangjitur shkresave të lëndës, andaj gjykata zyrtarisht ka kërkuar nga QKMF-ja në Kamenicë që ta njoftojnë gjykatën në bazë të shënimeve që posedojnë për personin E. H. H. se me datë 15.03.2014 a është trajtuar në QKMF- në Kamenicë.

Qendra Kryesore e mjekësisë familjare në Kamenicë me numër të referencës 08/248 datës 10.05.2016 ka informuar gjykatën me një shkresë se QKMF-ja në Kamenicë pas verifikimit të protokolleve që posedon si dhe të dhënave të dërguara nga departamenti i sistemit informativ shëndetësor-Prishtinë për datën 15.03.2014 nuk është evidentuar dhënja e trajtimit mjekësor për pacientin E. H.

Gjykata analizoi deklaratën e të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit E. H. i cili në kohën kur pretendohet se është kryer vepra penale ka qenë fëmijë, deklaratës të të dëmtuarit gjykata nuk ia fali besimin pasi e njëjta ra në kundërshtim me provat tjera të proceduara në shqyrtimin kryesor, si me deklaratën e dëshmitarit I. B. i cili menjëherë ka dalur në vend të ngjarjes dhe ka sqaruar se në momentin kur ka kontaktuar me të dëmtuarin i njëjti nuk ka pasur shenja në fytyrë siq pretendon i dëmtuari, gjithashtu të dëmtuarit i kanë ofruar që ta dërgojnë në kontrollim mjekësor nëse ka nevojë, por i dëmtuari ka refuzuar, ndërsa në shqyrtimin gjyqësor i dëmtuari deklaroi se pas incidentit ka qenë në kontrolle në QKMF në Kamenicë mirëpo policia nuk ia kanë bashkangjitur dokumentacionin lëndës, gjë që u demantua nga QKMF-ja se me datë 15.03.2014 nuk është evidentuar dhënia e trajtimit mjekësor për pacientin E. H. Sa i përket dëshmitarit Sh. Sh. gjykata vërtetoi se i njëjti vetëm ka nënshkruar rastin duke u kujdesur se a janë kryer procedurat konform ligjit.

Gjykata nuk mund ta shpallë të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në deklaratën pa pasur prova tjera mbështetëse për të vërtetuar gjendjen faktike, i dëmtuari i cili në kohën kur pretendohet se është kryer vepra penale ka qenë fëmijë 12 vjeçar, gjykata pati parasysh personalitetin e një fëmije edhe nuk e mori si kredibile deklaratën e tij, pasi nuk pati prova tjera mbështetëse për ta vërtetuar gjendjen faktike.

Të gjitha provat e proceduara gjykata i ka vlerësuar me kujdes, çdo provë veç e veç dhe të tëra së bashku duke i vënë në korelacion reciprok, si edhe në raport me mbrojtjen e të akuzuarit në kuptim të nenit 8 dhe 361 të KPPRK-ës. Në bazë të një vlerësimi të këtillë të kujdesshëm të të gjitha provave të proceduara, gjykata me asnjë provë të vetme- të besueshme nuk mundi të vërtetoi faktin se i akuzuari kishte kryer veprën penale për të cilën ishte ngarkuar, i gjithë dyshimi për të inicuar procedurë penale kundër të akuzuarit ishte deklarata e një fëmiju 12 vjeçar- një supozim, e sipas dispozitave të KPPRK-ës përgjegjësia penale duhet të vërtetohet në mënyrë bindëse, pra në rastin konkret nuk është vërtetuar e njëjta, askush nuk mund të shpallet fajtor në bazë të supozimeve pa pasur prova të drejtpërdrejta të cilat do ta përshkruanin me saktësi ekzistimin e fakteve përkitazi me kryerjen e veprës penale, prandaj në të drejtën penale vlenë parimi "Indubio Pro Reo", pra mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij në mbështetje të nenit 3 parag. 2 të KPPRK-së.

Vendimi për ta udhëzuar të dëmtuarin për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është bazuar në nenin 463 par.3 të KPPRK-së.

Për shpenzimet e procedurës penale gjykata ka vendosur që ato të bien në barrë të mjeteve bugetore të kësaj gjykate, në kuptim të nenit 454 parag. 1 i KPPRK-së.

GJYKATA THEMELORE NE GJILAN- DEGA NE KAMENICE,

P.nr.93/2014, më datën 31.05.2016.

Sekretarja juridike,

Gj y q t a r j a,

Emine Zubaku,d.v.

Valbonë Dërvodeli,d.v.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej

15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së

Apelit në Prishtinë, për mes kësaj gjykate.